

VENDIM
Nr. 284, datë 21.5.2018

PËR PJESËMARRJEN E NJË GRUPI TRAJNUES SPECIAL TË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN USHTARAK
TË NATO-s “RESOLUTE SUPPORT MISSION” (RSM),
NË AFGANISTAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, pika 5, e 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurave të vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin me mision të një grupi trajnues special, të përbërë nga 12 (dymbëdhjetë) ushtarakë të Batalionit të Forcave Speciale, të Forcës Tokësore, të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të operacionit ushtarak të NATO-s “*Resolute Support Mission*” (RSM), në Afganistan.

2. Përpara dërgimit me mision të grupit trajnues special, në operacionin ushtarak “RSM” dhe gjatë tij të zhvillohet në rajonet dhe zonat e operacionit misioni i rikonicionit/përnjohjes për njohjen e terrenit të veprimit të palëve. Kohëzgjatja e këtij misioni të jetë deri në 15 (pesëmbëdhjetë) ditë dhe ekipi i rikonicionit/ përnjohjes të përbëhet nga 3 (tre) ushtarakë të fushave: komandim/kontroll, operacion/logjistikë dhe zbulim/siguri.

3. Misioni i grupit trajnues special është trajnimi, këshillimi dhe dhënia e ndihmës një batalioni sulmues të motorizuar të Forcave të Sigurisë Afgane për plotësimin me personel, stërvitjen dhe pajisjen për kalimin në batalion plotësisht të motorizuar, me qëllim partnerizimin e tij me Komandën e Operacioneve Speciale në mbështetje të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës Islamike të Afganistanit.

4. Venddislokimi i grupit trajnues special të jetë në Kabul, Afganistan.

5. Kohëzgjatja e këtij misioni është deri në 5 (pesë) vjet, afat i cili fillon të llogaritet nga data e dërgimit të grupit të parë në Afganistan, me sistem rotacioni. Periudha e rotacionit për çdo grup të jetë 6 (gjashtë) muaj, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me grupin e radhës.

6. Ministria e Mbrojtjes, për ushtarakët pjesëmarrës në këtë operacion, të përballojë shpenzimet, për:

- a) dietat, për ditët e qëndrimit, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pages mujore;
- b) sigurimin e jetës;
- c) sigurimin shëndetësor jashtë zonës së operacionit;
- ç) mbështetjen shëndetësore;
- d) ushqimin;
- dh) akomodimin;
- e) ujën;
- ë) energjinë elektrike;
- f) lavanderinë;
- g) shërbimin telefonik, postar dhe internetin;
- gj) transportin;
- h) transportimin e individëve të shkëputur të misionit për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline;
- i) aktivitete social-kulturore, në rastet e festave kombëtare, gjatë kohës së kryerjes së misionit;

j) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.

7. Ministria e Mbrojtjes, për ushtarakët pjesëmarrës në ekipin e rikonicionit/përnjohjes, të përballojë shpenzimet për:

a) Shpërblimin për vështirësi shërbimi, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) sigurimin shëndetësor jashtë zonës së operacionit;

ç) mbështetjen shëndetësore;

d) ushqimin;

dh) akomodimin;

e) ujin;

ë) energjinë elektrike;

f) lavanderinë;

g) shërbimin telefonik, postar dhe internetin;

gj) ransportin;

h) transportimin e individëve të shkëputur të misionit për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline;

i) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së misionit të rikonicionit/përnjohjes.

8. Transporti i personelit që do të shërbejë në Afganistan, ndërsa nis, ndryshon dhe përfundon detyrën për t'u kthyer në Shqipëri, mbështetja shëndetësore, akomodimi, ushqimi, uji, energjia elektrike, lavanderia, transporti i individëve të shkëputur nga operacioni për në atdhe në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline do të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, përveç rasteve kur do të arrihet nënshkrimi i marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe, ku pala/palët tjetër/e tjera të marrë/marrin përsipër të përballojë/përballojnë këto shpenzime.

9. Ministria e Mbrojtjes të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet për ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët do të marrin pjesë në këtë mision.

10. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

11. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama